



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 372/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Bashkim Ademaj në cilisin e Zyrtarit të lartë Komunal Zgjedhor (ZLKZ) dega në Istog, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Istog, për shkak të mbajtjes së tubimit elektoral pa paralajmërim, në seancën e panelit të mbajtur me 31.10.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Bashkim Ademaj Zyrtar i lartë Komunal Zgjedhor (ZLKZ), dega në Istog.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 29.10.2013, nga Bashkim Ademaj (ZLKZ) dega në Istog, në të cilën theksohet se me datë 18.10.2013 në Shtëpinë e Kulturës në fshatin Istog i Poshtëm është mbajtur një tubim politik i pa lajmëruar i AAK-së ku kanë marrë pjesë rreth (njëqindnjëzet) 120 persona, ku kanë prezantuar programin e partisë nga kandidatët e AAK-së thuhet në ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**

Pretendimet e ankuesit në ankesën e tij se subjekti politik AAK ka mbajtur tubim elektoral pa paralajmërim PZAP-i i vlerëson si të pabazuar dhe të pa argumentuar në fakte dhe dëshmi konkrete pasi që ankesës në fjalë nuk i ka bashkangjitur asnjë dëshmi bindëse. Prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

## Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 372/2013 më datën 31.10.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Xhevdet Abazi**



***Këshillë Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*